



Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Komuna-Municipality
Hani i Elezit



04/3637/2024

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN PRILL 2024

Hani i Elezit, 2024

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin prill 2024, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësiwe, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit prill kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2024 është në lartësi prej **3,349,278.00 Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa.....2,075,272.00 €,
- Mallra dhe shërbime.....524,500.00 €,
- Shpenzimet komunale93,500.00 €,
- Subvencione dhe transfere ...113,000.00 €,
- Shpenzime kapitale543,006.00 €,
- Totali i buxhetit.....3,349,278.00 €.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Përgatitja e raportit mujor të të hyrave dhe shpenzimeve të muajit mars 2024 dhe publikimi në ueb faqen e Komunës,
- Përgatitja e raportit të punës dhe aktiviteve të Drejtorisë Buxhet dhe Financa për muajin mars 2024 dhe dorëzimi i të njejtit në Kabinetin e Kryetarit si dhe publikimi në ueb faqen e Komunës në formatin PDF dhe Word,
- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale të muajit mars 2024,
- Barazimi me Thesar për muajin mars 2024,
- Përgatitja dhe publikimi i borxhit publik për muajin mars në ueb faqe të Komunës,
- Është bërë kërkesa për marrjen e shërbimit për kryerjen e Auditimit të Brendshëm në Njësinë e Auditimit të Brendshëm – MFPT për vitin 2023, në mungesë të Auditorit të Brendshëm,
- Është bërë kërkesa për alokimin e të hyrave të muajit mars nëpër Programe dhe kategori buxhetore, duke u bazuar në Planifikimet Buxhetore,
- Është përgatitur Raporti Financiar Janar-Mars 2024 dhe është dorëzuar për KPF dhe Kuvend Komunal,
- Është realizuar bartja e bilancit të pashpenzuar (fondi 22) nga Departamenti i Buxhetit – MFPT,
- Është përgatitur Raporti i monitorimit sipas periudhave (Q1), për periudhën janar-mars 2024 dhe dorëzuar në Departamentin e Buxhetit – MFPT ,
- Kemi pranuar raportin e të hyrave indirekte për TM1 Janar-Mars 2024, ku të hyrat nga gjobat e Policisë janë në shumë prej 13,360.00 € dhe nga Agjenisoni Pyjor i Kosovës në shumë prej 2,122.56 €.
- Ka vazhduar procesi i Auditimit të vitit 2023 nga Zyra Kombëtare e Auditimit,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN MARS 2024

Kategoritë Buxhetore	Buxheti sipas Ligjit nr. 08/L-260	Buxheti Final	Realizimi Prill 2024	% e Realizimit Prill	% Realizimit Janar-Prill
Paga dhe Shtesa	2,075,272.00	2,153,367.87	167,063.70	7.7 %	33.5 %
Mallra dhe Shërbime	524,500.00	527,058.06	46,147.53	8.7 %	27.6 %
Shpenzime Komunale	93,500.00	93,500.00	8,360.12	8.9 %	28.1 %
Subvencione dhe Transfere	113,000.00	116,327.58	46,575.00	40.03 %	45.2 %
Shpenzime Kapitale	543,006.00	1,001,480.68	68,702.70	6.8 %	6.8 %
Totali	3,349,278.00	3,891,734.19	336,849.05	8.6 %	26.07 %

SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2024 është në shumë prej 274,376.00 €.

Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsej për muajin prill 2024 nga të hyrat direkte 21,357.84 € dhe paraqesin 7.7 % e planit të të hyrave vetanake. Poashtu, gjatë muajit prill 2024 kemi pranuar edhe raportin e të hyrave indirekte ë gjobave në trafik nga Policia në shumë prej 13,360.00 € si dhe nga Agjensioni Pyjor i Kosovës në shumë prej 2,122.56 € për TM1.

Në bazë të drejtorive për muajin prill 2024 kemi inkasuar këto të hyra:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka inkasuar të hyra në shumë prej 8,754.90 €;
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka inkasuar të hyra në shumë prej 1,931.00 €;
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ka inkasuar të hyra në shumë prej 6,716.48 €;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia ka inkasuar të hyra në shumë prej 1,224.60 €;
- Drejtoria e Urbanizmit ka inkasuar të hyra në shumë prej 919.36 €;
- Drejtoria e Arsimit ka inkasuar të hyra në shumë prej 1,200.00 €;
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka inkasuar të hyra në shumë prej 611.50 €;

Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto aktivitete:

- Përpunimi, harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave sipas programeve buxhetore, fondeve dhe kodeve ekonomike në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK),

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka pasur këto aktivitete:

- Shërbime të rregullta ndaj qytetarëve,
- Është finalizuar shpërndarja e faturave të tatimit në pronë për vitin 2024 nga Posta e Kosovës,
- Është përfunduar Raporti i Inspektimit të tatimit në pronë për vitin 2023,
- Është dorëzuar projeksioni i ngarkesës tatimore për tatimin në pronë (objekte dhe parcela) 2025-2027 në DTP-MFPT,
- Është përgatitur një referencë pozitive për Postën e Kosovës, për shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë për vitin 2024.

Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

L. Ballazhi

